



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

RAPORT

Grantet për Biznese 2023

Nëntor, 2023

Përmbajtja:

Raporti për Grante.....	4 faqe
Thirrja për Aplikim.....	6 faqe
Forma e Aplikimit Lot I.....	4 faqe
Forma e Aplikimit Lot II.....	4 faqe
Komisioni për Vlerësim.....	1 faqe
Kriteret e përzgjedhjes.....	1 faqe
Vlerësimi i objektivave në teren Lot I dhe Lot II.....	2 faqe
Komisioni për Ankesa.....	1 faqe
Komisioni për monitorim.....	1 faqe
Lista përfituesve Lot I dhe Lot II.....	2 faqe
Raporti, Bizneset jo Përfituese Lot I.....	10 faqe
Raporti, Bizneset Përfituese Lot I.....	4 faqe
Raporti, Bizneset jo Përfituese Lot II.....	16 faqe
Raporti, Bizneset Përfituese Lot II.....	19 faqe
Vendimi për pagesat e mjeteve buxhetore.....	1 faqe

R A P O R T

Grantet për Biznese 2023

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK në Komunën e Gjakovës edhe këtë vit ka vazhduar me ndarjen e Granteve për Biznese.

Me datën 12.05.2024 është bërë publike Thirrja për aplikim, shpallja e konkursit për Grantet për Biznese për vitin 2024, të angazhuara në fushë të prodhimit, përpunimit dhe arti zanateve tradicionale.

Qëllimi i Granteve komunale është që të synohet zgjerimi dhe forcimi i kapaciteteve të tyre, të nxitet rritja e punësimit; të sigurohet qëndrueshmëria dhe të jenë aktive në mënyrë që bizneset e tyre të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal të Komunës së Gjakovës.

Vlera e financimit të një Granti ishte nga **2,000 €** deri **4,000 €** për Start-up dhe **3,000 €** deri në **6,000€** për ndërmarrjet mikro dhe të vogla.

Lot I

Vlera totale e Granteve **Lot I** - 29,072.22€ ndërsa vlera mesatare e një Granti ka qenë 3,230.25 €, ku janë përzgjedhur 9 përfitues prej të cilëve 5 janë biznese të udhëhequra nga gratë dhe 4 janë biznese të udhëhequra nga burrat.

Lot II

Vlera totale e Granteve **Lot II** - 79,960.50 € ndërsa vlera mesatare e një Granti ka qenë 4,703.55€, ku janë përzgjedhur 17 përfitues prej të cilëve 4 janë biznese të udhëhequra nga gratë dhe 13 janë biznese të udhëhequra nga burrat.

Vlera e përgjithshme e ndarë nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik për biznese për vitin 2023 ishte **109,032.72 €**. Në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej **138 biznese**, nga këto **85 biznese ekzistuese** dhe **53 Start up**. Komisioni për Vlerësim të dokumentacionit ka shpallur **26 biznese fituese**, **9 biznese** në total të udhëhequra nga **gratë** dhe **17 biznese** në total të udhëhequra nga **burrat**. Bizneset kanë participuar më së paku me **20 %** të vlerës së Grantit të fituar, varësisht nga kostoja e pajisjes, dhe nga vlera e Grantit të fituar. Me këto Grante është bërë blerja e

pajisjes/ve dhe mjeteve të punës për përfituesit e Granteve. Në bazë të ndarjes sipas veprimtarive Grantet janë dhënë për prodhim/përpunim dhe zejtari.

Bizneset e udhëhequra nga Gratë, nga të Rinjtë nën moshën 35 vjeçare dhe bizneset nga Komuniteti pakicë kanë pasur përparësi në pikëzim, për arsye që Gratë, të Rinjtë dhe Minoritarët që i plotësojnë kriteret e konkursit të kenë përparësi.

Afati për aplikim ka qenë nga 12 Maji deri më 02 Qershor 2023 (ora 16:00) dhe ka qenë i publikuar në Web faqen e Komunës së Gjakovës, në rrjetin social Facebook dhe në tabelën zyrtare para Komunës.


Këto Grante janë bërë sipas Rregullores për ndarjen e Subvencioneve, Janar 2020. Gjatë periudhës në të cilën afati për aplikim ka qenë i hapur, me vendim të Kryetarit Z. Ardian Gjini kemi formuar edhe Komisionet të cilat janë të domosdoshme për ecurinë e punës. Komisioni për shqyrtimin dhe Vlerësimin e dokumentacionit, i cili e bënë përzgjedhjen e projekteve fituese me 5 anëtar, (1 nga jashtë – shoqëria civile), Komisioni i Ankesave me 3 anëtar dhe Komisioni Monitorues me 3 anëtar. Ky komision e bënë mbikëqyrjen e përfituesve në periudhën 2 vjeçare për ecurinë e projekteve të financuara nga Komuna e Gjakovës.

Komisioni për Vlerësim ka shqyrtuar tërë dokumentacionin e të gjithë bizneseve aplikuese dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit kanë përpiluar listën preliminare. Më pas, për të vërtetuar gjendjen faktike të bizneseve që ishin në listën preliminare ju është bërë vizitë bizneseve dhe Komisioni ka konstatuar se këto biznese i plotësojnë kushtet që të jenë përfituese për Grantet e vitit 2023 dhe me datën 20.06.2023 kanë publikuar listën përfundimtare me 26 biznese përfituese.


Pas shpalljes së listës përfundimtare të përfituesve nga ana e Komisionit Vlerësues, është mundësuar parashtrimi i ankesave për bizneset e pa kënaqura, ku kemi pasur vetëm 3 ankesa nga bizneset jo përfituese, të cilat komisioni për Ankesa i ka kthyer si të pa baza dhe ka vazhduar të jetë si listë përfundimtare lista e shpallur nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlen të theksohet që është numër shumë i vogël i ankesave (3), gjithmonë duke pasur parasysh numrin e aplikuesve për Grantet e vitit 2023. Me këtë, vijmë në përfundim që bizneset e kanë pasur të qartë korrektësinë e Komisionit Vlerësues i cili ka bërë punën në mënyrën më transparente gjatë këtij procesi. Pas përfundimit të të gjitha procedurave të thirrjes për aplikim të ndjekura

sipas rregullores për ndarjen e subvencioneve është bërë edhe nënshkrimi i Kontratave me bizneset përfituese.

Grafikon 1: Ndarja e Granteve sipas Gjinisë në %



Grafikon 2: Ndarja e Granteve sipas Gjinisë në Vlerën €



Në përfundim të këtij Raporti lidhur me ndarjen e Granteve për biznese për vitin 2023 nga ana e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, në kuadër të Komunës së Gjakovës, e konsiderojmë si një proces korrekt dhe transparent, ku komisioni për vlerësim ka bërë punën e tyre në mënyrë të pavarur, duke renditur përfituesit në bazë të dokumentacionit të ofruar nga bizneset.

Ne si Drejtori e Zhvillimit Ekonomik besojmë që këto Grante do të jenë një stimulues për përfituesit në fuqizimin, zgjerimin e bizneseve, rritjen e punësimit dhe do të kenë impakt pozitiv në ekonominë e Gjakovës.



KOMUNA E GJAKOVËS



OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Đakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administratë
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove



06 Nr./Br. 413/M-9056

Data/Datum 12. 05. 2023

Gjakovë-Đakovica-Gjakova

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

THIRRJE PËR APLIKIM

Grante në kuadër të Programit
“Fondi Zhvillimor për Ndërmarrje Mikro dhe të vogla”

Maj 2023

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (DZHE) në Komunë të Gjakovës, në bazë të nenit 9 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës nr. 01-110/01-3560, në kuadër të Programit “Fondi Zhvillimor për Ndërmarrje Mikro” shpall këtë thirrje për aplikim për GRANTE të bizneseve lokale mikro të angazhuara në fushë të prodhimit, përpunimit dhe artizanateve tradicionale.

Qëllimi i Programit “Fondi Zhvillimor për Ndërmarrje Mikro” është që të ndikojë në gjenerimin e vendeve të punës, përmirësimin e mirëqenies sociale, si dhe zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Gjakovës.

Granti do të ndahet në dy Lot, si vijon:

Loti 1 – Start-up;

Loti 2 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla

Vlera e financimit të një Granti

Loti 1 – Start-up; nga *2,000 deri në 4,000 Euro*

Loti 2 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla nga *3,000 deri në 6,000 Euro*

Sqarim: Sipas kategorizimit të ATK-së dhe sipas Ligjit Nr. 04/L-220 për Investime të Huaja, ndërmarrjet mikro dhe të vogla kategorizohen:

1. Ndërmarrjet mikro prej 0-9 punëtor;
2. Ndërmarrjet e vogla prej 10-49 punëtor.

I. KRITERET E GRANTIT: Loti I

1. Përfituesi duhet të regjistrohet në Zyrën për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) në Komunë të Gjakovës dhe të operojë në komunën e Gjakovës, ku edhe duhet të bëhet investimi;
2. Të gjeneroj punësim me marrjen e grantit;
3. Aplikuesit të cilat promovojnë ide kreative dhe inovative në tregun tonë do të kenë përparësi;
4. Përparësi kanë aplikuesit nën moshën 35 vjet, gratë, të rinjtë, nga komunitetet pakicë, të cilat nuk kanë përfituar asnjëherë nga fondet e Komunës së Gjakovës;

5. Në momentin e kompletimit të dokumentacionit aplikuesi duhet të dorëzojë Profaturën/Ofertën për paisjet dhe mjetet e punës të planifikuara për investim;
6. Aplikuesi duhet të kontribuojnë me vetëfinancim, më së paku më 20% të vlerës së grantit të fituar, varësisht nga kostoja e pajisjes, dhe nga vlera e grantit të fituar.

II. KRITERET E GRANTIT: Loti II

1. Bizneset duhet të jenë të regjistruara në ARBK dhe të operojë në komunën e Gjakovës, ku edhe duhet të bëhet investimi;
2. Biznesi duhet të ketë të punësuar së paku *NJË* punonjës përveç pronarit.
3. Të gjeneroj punësim me marrjen e grantit;
4. Bizneset duhet të dëshmojnë se janë funksionale, të qëndrueshme në treg dhe kanë kapacitet të mjaftueshëm për zgjerimin e prodhimit, qarkullimit dhe rritjen e numrit të punonjësve. *Këtë e dëshmojnë përmes deklarimeve të ATK-së për periudhën TM4 2022 dhe TM1 2023;*
5. Bizneset të cilat promovojnë ide kreative dhe inovative në tregun tonë do të kenë përparësi;
6. Përparësi kanë bizneset që udhëhiqen nga gratë, të rinjtë nën 35 vjet, nga komunitetet pakicë, dhe ato biznese të cilat nuk kanë përfituar asnjëherë nga fondet e Komunës së Gjakovës;
7. Në momentin e aplikimit biznesi duhet të dorëzojë Profaturën/Ofertën për paisjet dhe mjetet e punës të planifikuara për investim;
8. Bizneset duhet të kontribuojnë me vetëfinancim, më së paku më 20% të vlerës së grantit të fituar, varësisht nga kostoja e pajisjes, dhe nga vlera e grantit të fituar.
9. Bizneset duhet të dëshmojnë se i kanë të paguara obligimet ndaj ATK-së, tatimit në pronë dhe taksës në firmë.

II. ÇFARË FINANCOHET NGA GRANTI: Loti I dhe Loti II

1. Blerja e pajisjeve dhe mjeteve të punës duhet të jenë të reja.

III. KRITERET JOKUALIFIKUESE: Loti I dhe Loti II

Aplikantët potencialë nuk mund të marrin pjesë në këtë thirrje apo të përfitojnë grant nëse gjenden në ndonjërin prej situatave që renditen si më poshtë:

1. Bëjnë pjesë në njërin prej veprimtarive si: tregtia (me pakicë e shumicë), ndërtimtaria, shëndetësia dhe sallonet e ondulimit;
2. Paraqet veti diskriminuese apo ka ndikim negativ në shoqëri dhe komunitet;
3. I shkakton dëme ambientit apo ndonjë grupi tjetër të marginalizuar;
4. Keni qenë përfitues të Granatit nga DZHE- Komuna e Gjakovës;
5. Ka orientime apo qëllime politike;
6. Kërkon grante për të blerë tokën për ndërtim;
7. Merret vetëm me tregtimin e produkteve;
8. OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë;
9. Keni bërë ndryshim në biznes pas datës së shpalljes publike për Aplikim;
10. Nëse vlera e finacimit të projektit është nën ose mbi shumën e vlerës që financohet nga Komuna;
11. Nëse mungon një dokumuent i kërkuar nga Dokumentet e kërkuar për aplikim;

IV. PROCEDURA E APLIKIMIT

Forma e Aplikacionit mund të merret duke klikuar në ueb-faqen zyrtare të Komunës në linkun: <https://kk.rks-gov.net/gjakove/category/konkurset-njoftimet/aplikacione/> , si dhe i njëjti mund të merret pranë Qendrës për Informim në objektin e Komunës së Gjakovës.

Pasi ta keni plotësuar aplikacionin, së bashku me dokumentacionin mbështetës që kërkohet, duhet të aplikoni **në formën fizike në zyrën e Arkivës të Komunës së Gjakovës**, ku protokollohet dokumentacioni dhe ju do të merrni numrin e protokollit, që dëshmon se JU KENI APLIKUAR.

Një aplikant nuk mund të dorëzojë më shumë se një aplikacion në këtë thirrje.

Për çdo paqartësi, mund të dërgohen pyetje shtesë në email-in vijues: gjakova.biz@rks-gov.net jo më së voni deri më 01 Qershor 2023, si dhe duhet të tregojë qartë referencën për programin. Komuna nuk ka për obligim të ofrojë qartësime të mëtutjeshme ndaj pyetjeve që dorëzohen pas këtij afati.

V. AFATI I APLIKIMIT:

Afati i aplikimit është 12 Maj deri 02 Qershor 2023 ora 16:00

VI. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM: Loti I

1. Aplikacioni
2. Kopje e letërnjoftimit;
3. Oferta / Profatur me të gjitha shënimet e duhura që specifikacion pajisjet apo mjetet e punës me çmimin përkatës;
4. Reference, certifikatë, trajnim

VII. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM: Loti II

1. Aplikacioni;
2. Kopje e letërnjoftimit;
3. Kopje e Certifikatës së Biznesit me të gjitha informatat përcjellëse (certifikata duhet të jetë e re, lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues);
4. Deklarata vjetore e qarkullimit e raportuar në ATK (TM 4) për vitin 2022 dhe (TM 1) 2023;
5. Listën e punëtorëve për vitin 2022 dhe 2023 të lëshuar nga ATK (mund të nxjerrët online nga ueb-faqja e ATK-së);
6. Oferta / Profatur me të gjitha shënimet e duhura si: numri i regjistrimit të biznesit, numri i pro faturës, emri i plotë i furnitorit (shitësit), adresa e saktë , nënshkrimi dhe vula e shitësit, dhe të gjitha të dhënat tjera të rëndësishme për furnitorin ku do të blihet pajisja/et, specifikacionin dhe fotot e pajisjeve apo mjeteve të punës me çmimin përkatës;
7. Vertetimi i ATK-së, tatimit në pronë dhe taksës në firmë;
8. Konfirmimi Bankar i Biznesit.

VIII. PROCEDURAT E VLERËSIMIT:

Faza e parë e vlerësimit të aplikacioneve do të përfshijë një "kontroll administrativ" për të siguruar që aplikantët kanë përmbushur rregullat e kualifikimit dhe dokumentet e kërkuara për aplikim. Përderisa, faza e dytë dhe përfundimtare përfshinë vlerësimin përmbajtësor të aplikimit duke u bazuar në kriteret përzgjedhëse dhe nëse ndërmarra ka perspektivë të mirë të të qenit e suksesshme dhe e qëndrueshme, si dhe që implementimi do të kontribuojë drejt përmbushjes së qëllimit të Thirrjes për Grante. Grantet do t'i jepen aplikantëve me pikët më të lartë të mbledhura.

IX. FORMA E PAGESËS SË GRANTIT:

Shuma e financimit të fondeve publike komunale për grante ndahet në 2 lote

Loti I { start-up} shuma totale e fondit 30,000.00 €

Loti II shuma totale e fondit 80,000.00 €

Grantet jepen në formën e parave të gatshme, pasi që biznesi sjell dëshminë respektivisht faturën e rregullt për blerjet (investimet) që i ka bërë, e të cilat duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me kërkesën për investim që e ka dëshmuar me profaturë/ofertë.

SQARIM PËR START-UP:

Pas publikimit të listës përfundimtare për start-up, përfituesit janë të obliguar të regjistrojnë veprimtarinë biznesore si entitet ligjor në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës, para nënshkrimit të kontratës.

Përfituesi duhet të hapë xhirrollogarinë në emër të Biznesit.

SQARIM: Nëse zgjidheni përfitues i grantit, atëherë nënshkruhet Kontrata me Komunën/DZHE dhe pastaj duhet të sjellët **Fatura dhe transferi bankar** e bërë nga xhirrollogaria e biznesit tuaj tek operatori ekonomik (shitësi), me të cilën dëshmohet blerja e pajisjes/ve. Atëherë Komuna e bënë rimbursimin e mjeteve financiare në vlerën e grantit.



DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK
GRANTET 2023
FORMA E APLIKACIONIT
LOT I - START UP

I. INFORMATAT E PËRGJITHSHME TË APLIKANTIT	
1. Emri dhe Mbiemri:	
2. Datëlindja:	
3. Gjinia:	☐ Femër ☐ Mashkull
4. Numri personal:	
5. Vendbanimi:	
6. Profesioni:	
7. Etniciteti:	☐ Shqiptar ☐ Tjetër: _____
8. Numri telefonit:	
9. E-mail adresa:	
II. PËRSHKRIMI I SHKURTËR I PROJEKTIT/PLANIT TË BIZNESIT	
10. Përshkruani idenë e Projektit / Planin e Biznesit Tuaj :	

11. Çka planifikoni të prodhoni apo të përpunoni, çfarë shërbimesh do të ofroni:

Produktet / shërbimet të cilat i ofroni:

1.

2.

3.

4.

5.

PËRFITUESIT

Numri i të punësuarëve si rezultat i Grantit:

1.

2.

REZULTATE E PRITSHME NGA GRANTI:

Cilat janë rezultatet e pritshme që do të arrihen përmes këtij granti?

1.

2.

3.

13. Zhvillimi Biznesit tuaj:

KLIENTET E BIZNESIT

Kush janë konsumatorët / klientët tuaj?

1.

2.

Promovimi	
Ku dhe Si do t'i promovoni prodhimet/produktet apo shërbimet e juaja?	
1.	
2.	

14. Përshkruani strukturën organizative që do të planifikoni në projektin tuaj:	
Punonjës me orar të plotë?	
Punonjës me kohë të pjesëshme?	
Praktikantët - Punonjësit e rinjë?	

15. A keni marrë ndonjë fond nga burime / organizata tjera?		☐ PO	☐ JO
Nëse PO ju lutem plotësoni te dhënat e mëposhtme			
Emri i Donatorit			
Shuma e përfituar në Euro			
Viti përfitimit të fondit			

16. Pajisjet, makina, mjetet e punës te kërkuara përmes këtij projekti:				
Emri i pajisjes, mjetit të punës	SPECIFIKACIONI (Modeli, lloji, furnizuesi, karakteristikat teknike, viti i prodhimit, etj.)	Çmimi për njësi	Sasia kërkuar	Vlera totale €URO
Vlera totale e projektit:				

<i>Burimet Financiare:</i>	Shuma (€)	%
Kontributi personal		
Granti Komunal		
Tjera (specifiko)		
Shuma Totale		

Aplikanti vërteton se informacioni i dhënë këtu është i vërtetë sipas njohurive të tij më të mira dhe pranon detyrimin për të respektuar afatet dhe kushtet e DZHE-së / Komunës të cilat janë në fuqi në kohën e dhënjes së Grantit

Nënshkrimi:

(Nënshkrimi)

Datë: _____



DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK
GRANTET 2023
FORMA E APLIKACIONIT
LOT II - BIZNESET EKZISTUESE

I. INFORMATAT E PËRGJITHSHME TË APLIKANTIT	
1. Emri dhe Mbiemri:	
2. Datëlindja:	
3. Gjinia:	☐ Femër ☐ Mashkull
4. Numri personal:	
5. Vendbanimi:	
6. Profesioni:	
7. Etniciteti:	☐ Shqiptar ☐ Tjetër: _____
8. Numri telefonit:	
9. E-mail adresa:	
II. INFORMATAT E PËRGJITHSHME TË BIZNESIT	
10. Emri i Biznesit:	
11. Nr. Unik i Biznesit	Nr. Unik: _____
12. Statusi Legal i Biznesit:	☐ Biznes Individual ☐ SHPK ☐ tjetër _____
13. Pronari (ët), Përfaqësuesi (t) ligjor:	
14. Adresa e Biznesit:	
15. Personi i Autorizuar ligjor:	
16. Emri i Bankës, Xhirollogaria e Biznesit:	

III. PËRSHKRIMI I SHKURTËR I PROJEKTIT/PLANIT TË BIZNESIT

17. Përshkruani gjendjen e tanishme të Biznesit tuaj :

18. Përshkruani idenë e Projektit / Planin e Biznesit Tuaj :

19. Çka planifikoni të prodhoni apo të përpunoni, çfarë shërbimesh do të ofroni:

Produktet / shërbimet të cilat i ofroni:

1.

2.

3.

4.

5.

PËR FITUESIT	
Numri i të punësuarëve si rezultat i Grantit:	
1.	
2.	

REZULTATE E PRITSHME NGA GRANTI:	
Cilat janë rezultatet e pritshme që do të arrihen përmes këtij granti?	
1.	
2.	
3.	

20. Zhvillimi Biznesit tuaj:	
KLIENTET E BIZNESIT	
Kush janë konsumatorët / klientët tuaj?	
1.	
2.	

Promovimi	
Ku dhe Si do t'i promovoni prodhimet/produktet apo shërbimet e juaja?	
1.	
2.	

21. Përshkruani strukturën organizative të biznesit tuaj:	
Punonjës me orar të plotë / nëse keni sa janë?	
Punonjës me kohë të pjesëshme / nëse keni sa janë?	
Praktikantët - Punonjësit e rinj / nëse keni sa janë?	

22. A jeni përfitues nga skema e Granteve Komunale paraprake?	
☐ PO ☐ JO	

23. A keni marrë ndonjë fond nga burime /organizata tjera?		☐ PO	☐ JO
Nëse PO ju lutem plotësoni te dhënat e mëposhtme			
Emri i Donatorit			
Shuma e përfituar në Euro			
Viti përfitimit të fondit			

24. Pajisjet, makina, mjetet e punës te kërkuara përmes këtij projekti:				
Emri i pajisjes, mjetit të punës	SPECIFIKACIONI (Modeli, lloji, furnizuesi, karakteristikat teknike, viti i prodhimit, etj.)	Çmimi për njësi	Sasia kërkuar	Vlera totale EURO
Vlera totale e projektit:				

Burimet Financiare:	Shuma (€)	%
Kontributi personal		
Granti Komunal		
Tjera (specifiko)		
Shuma Totale		

Aplikanti vërteton se informacioni i dhënë këtu është i vërtetë sipas njohurive të tij më të mira dhe pranon detyrimin për të respektuar afatet dhe kushtet e DZHE-së / Komunës të cilat janë në fuqi në kohën e dhënjes së Grantit

Nënshkrimi:

(Nënshkrimi dhe Vula)

Datë: _____



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 112/A2-11725

Dt: 05.06.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me formimin e komisionit për vlerësimin e aplikacioneve të granteve - 2023, me datë 05.06.2023 merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për vlerësimin e aplikacioneve për grantet 2023, në këtë përbërje:

1. Lon Ibishi – kryesues
2. Behar Vula – anëtar
3. Marigona Mati – anëtare
4. Muharrem Sylmetaj – anëtar
5. Abnore Morina – anëtare

2. Komisioni i përshkruar si në pikën e parë të këtij vendimi, duhet të ndërmerr veprime konform legjislacionit në fuqi dhe thirrjes publike për vlerësimin e aplikacioneve të grantit në kuadër të programit “Fondi Zhvillimor për Ndërmarrje Mikro dhe të Vogël.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
- Të gjithë anëtarëve të komisionit
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



GRANTET PËR BIZNESE 2023
VLERËSIMI ME PIKË I DOKUMENTACIONIT TË APLIKUESIT

Emri i aplikuesit _____ Veprimtaria _____ Nr. Protokollit _____
Adresa Biznesit _____ Nr. Tel. _____ Shuma e Kërkuar _____

Nr.	Kriteret Vlerësuese	Pikët Max.	Vlerësimi i Komisionit
1	Përmbajtja e Aplikacionit e plotësuar	20	
2	Relevanca e investimit të planifikuar	20	
3	Biznesi që do të krijojë vetëpunësim.(nëse aplikuesi është pa punë)	20	
4	Biznesi që do të udhëhiqet nga minoritaret	5	
5	Biznesi që do të udhëhiqet nga femrat	10	
6	Biznesi që do të udhëhiqet nga të rinjtë nën 35 vjeçar	5	
7	Diploma, Trajnime dhe referenca	10	
8	Bizneset të cilat promovojnë ide kreative dhe inovacion	10	
	Totali:	100	

Komisioni i Vlerësimit në baze të shqyrtimit të dokumentacionit, merre këtë:

VENDIM

1. KUALIFIKOHET PËR LISTEN PRELIMINARE
2. NUK KUALIFIKOHET PËR LISTEN PRELEMINARE

Komisioni Vlerësues:

Lon Ibishi, Kryesues _____ Behar Vula, Anëtar _____ Marigona Mati Anëtare _____

Muharrem Sylmetaj, Anëtar _____ Avnora Morina, Anëtare _____

Gjakovë, ____/____/____



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



GRANTET PËR BIZNESE 2023
VLERËSIMI ME PIKË I DOKUMENTACIONIT TË APLIKUESIT

Emri Biznesit _____ Veprimtaria _____ Nr. Protokollit _____
Adresa Biznesit _____ Nr. Tel. _____ Shuma e Kërkuar _____

Nr.	Kriteret Vlerësuese	Pikët Max.	Vlerësimi i Komisionit
1	Përmbajtja e Aplikacionit e plotësuar	20	
2	Relevanca e investimit të planifikuar	20	
3	Qëndrueshmëria financiare e biznesit sipas ATK-së	20	
4	Bizneset që udhëhiqen nga minoritaret	5	
5	Bizneset që udhëhiqen nga femrat	10	
6	Bizneset që udhëhiqen nga të rinjtë nën 35 vjeçar	5	
7	Potenciali i biznesit për të krijuar vende të reja të punës	10	
8	Bizneset të cilat promovojnë ide kreative dhe inovacion	10	
	Totali:	100	

Komisioni i Vlerësimit në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit, merre këtë:

VENDIM

1. KUALIFIKOHET PËR LISTEN PRELIMINARE
2. NUK KUALIFIKOHET PËR LISTEN PRELIMINARE

Komisioni Vlerësues:

Lon Ibishi, Kryesues _____ Behar Vula, Anëtar _____ Marigona Mati Anëtare _____

Muharrem Sylmetaj, Anëtare _____ Avnora Morina, Anëtar _____

Gjakovë, ____/____/____



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Grantet për Biznese 2023

Vlerësimi i objektivave dhe kritereve pas vizitave në teren

Vlerësimi me Pro / Kundër i Objektivave & Kritereve të Projektit pas vizitave të realizuara në teren

Komisioni i vlerësimit pas shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara nga aplikuesi si dhe rezultateve të dala nga vizita e kryer në teren për biznesin: _____

me pronar/e: _____, me nr. protokollit _____.

Merr këtë vendim:

Pas vizitës në teren nga anëtarët e komisionit konstatojmë se:

KUALIFIKOHET ☐

NUK KUALIFIKOHET ☐

Si fitues i Grantit në vlerë _____, nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Gjakovës.

Komisioni Vlerësimit:

Kryesues _____

Anëtar _____

Anëtar _____

Anëtare _____

Anëtar _____

Gjakovë, me ____/____/____



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 112/02-11741
Dt: 05.06.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarjen granteve 2023, me datë 05.06.2023 e merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e granteve 2023, në këtë përbërje:
 1. Dalon Kulludra - Kryesues i Komisionit
 2. Brilanda Ballata - anëtare
 3. Leon Kuburja - anëtar
2. Komisioni i përshkruar si në pikën e parë të këtij vendimi, duhet të ndërmerr veprime konform legjislacionit në fuqi, që të shqyrtoj ankesat e palëve dhe të vendos lidhur me ankesat për ndarjen e granteve 2023.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria e Zhvillim Ekonomik

06/Zyrtare

Datë: 15.08.2023

Pasi që kanë përfunduar procedurat e Granteve për Biznese për vitin 2022, dhe janë shpallur bizneset përfituese Drejtori për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Gjakovës merre këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni për monitorimin e bizneseve përfituese të Grantit për Biznese të vitit 2022.

- | | | |
|----|-------------------------|-----------------|
| 1. | Kujtim Asllani | Kryesues |
| 2. | Marigona Palushi | Anëtar |
| 3. | Simon Deda | Anëtar |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Komisioni në përbërje të përshkruar në piken e pare të këtij vendimi duhet të bëjë monitorimin e përfituesve të Grantit për biznese për vitin 2022, në periudhën 2 vjeçare, siç e parasheh rregullorja për subvencione.

Vendimi ju dërgohet:
Anëtareve të Komisionit
Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik

Ferdinand Kolaj


Drejtör i DZHE-së



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik



LISTA PRELIMINARË E BIZNESEVE START UP TË CILËT JANË PËRFITUES TË GRANTEVE KOMUNALE 2023
LOT - I

	Numri i Lëndës	Emri i aplikuesit	Adresa e Biznesit	Piket
1	06-413/01-11425	Altina Podrimja	Rr: Wesley Clark	90
2	06-413/01-11563	Shkozeta Mati	Gjakovë	90
3	06-413/01-11206	Vlera Hyla	Gjakovë	85
4	06-413/01-11582	Aldi Hoxha	Gjakovë	80
5	06-413/01-11437	Lida Syla	Fsh: Lugbunar	75
6	06-413/01-11291	Andi Krasniqi	Gjakovë	75
7	06-413/01-11212	Ernes Muhaxhiri	Gjakovë	70
8	06-413/01-10858	Silvane Alija	Rr: Nikaj	65
9	06-413/01-11074	Rinor Beqaj	Fsh: Rracaj	65

VËREJTJE: Lista e pritjes vlenë vetëm për këtë thirrje të granteve për vitin 2023

1	06-413/01-11410	Drilon Krelani	Gjakovë	60
2	06-413/01-11562	Bruneta Malazogu	Gjakovë	60
3	06-413/01-11338	Oneda Shehu	Gjakovë	60
4	06-413/01-11260	Litafete Bajrami	Fsh: Popoc	55

Komisioni Vlerësues:

Lon Ibishi, kryesues:
Muharrem Sylmetaj, anëtar:
Behar Vula, anëtar:
Marigona Mati, anëtare:
Avnora Morina, anëtare:

Gjakovë

Data: 20.06.2023



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

LISTA PRELIMINARE E BIZNESEVE EKZISTUESE TË CILËT JANË PËRFITUES TË GRANTEVE KOMUNALE 2023
LOT - II

	Numri i Lëndës	Emri i Biznesit	Adresa e Biznesit	Numri i Biznesit	Piket
1	06-413/01-11371	Zeliha Zeka B.I	Rr: Ganimete Terbeshi	810163783	90
2	06-413/01-11370	Jakova V Shpk	Rr:Drenica	810229824	80
3	06-413/01-11428	Jetesa Gutaj B.I	Rr: Adem Gutaj fsh.Gerc	811875949	80
4	06-413/01-11570	Gjokë Geci B.I	Fsh: Janosh	810225731	78
5	06-413/01-11327	Xhavit Alija B.I	Fsh:Hereq	810242420	75
6	06-413/01-11289	Bedra shpk	Fsh: Moglicë	810196445	75
7	06-413/01-11199	Teuta Dalladaku B.I	Rr: Deshmorët e Lirisë	811941849	75
8	06-413/01-11403	Gezim Shala B.I	Rr:Drilon Zeneli	811897844	73
9	06-413/01-11587	Vehat Hoti B.I	Rogovë	810000290	73
10	06-413/01-11509	Bashuk Nue B.I	Fsh. Pjetershan	810229361	73
11	06-413/01-11427	R-company sh.p.k	Rr: Mark Malota	810237108	70
12	06-413/01-11597	AR KOM shpk	UÇK	811953258	70
13	06-413/01-11295	Mirlinda Morina B.I	Rr: Mazllom Lakuci	811131862	70
14	06-413/01-11507	Nesim Berisha B.I	Rr: Mahmut Ukshini	811405233	65
15	06-413/01-10471	Dekorimi Group shpk	Babaj I Bokës	811999145	65
16	06-413/01-11445	Ajet Berisha B.I	Rr: Tahir Efendia	810226979	65
17	06-413/01-11433	Albert Q. Hoti B.I	Rr: Martiret Vejsa	811453860	65

VËREJTJE: Lista e pritjes vlenë vetëm për këtë thirrje të granteve për vitin 2023

1	06-413/01-11576	Gentiani Komtrashi Brovina	Rr: Dedë Gjon Luli	811144766	55
2	06-413/01-11531	Drin Shala B.I	Rr: Vehap Shita	811138876	55

Komisioni Vlerësues:

Lon Ibishi, kryesues:

Muharrem Sylmetaj, anëtar:

Behar Vula, anëtar:

Marigona Mati, anëtare:

Avnora Morina, anëtare:

Gjakovë

Data: 20.06.2023



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATË:	20.06.2023
REFERENC-Ë:	06/Zyrtarisht
PËR/ZA/TO:	Z. Ferdinand Kolaj, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
CC:	Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	DZHE
NGA/OD/FROM	Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për përfituesit e granteve për vitin 2023
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport për bizneset e kualifikuara për grantet 2023

R A P O R T I

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për Grand 2023.
Lot -I Start Up

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Postal address: UÇK Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 390-320-828

kk.rks-gov.net/gjakove/

Lënda 06-413/01- 11425 dt.01.06.2023

Aplikuesja **"Altina Podrimja"** nr. personal të ID **1244202426**

Komisioni konstaton se aplikuesja e lartë cekur ka plotësuar kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim dhe është vlerësuar me 90 pikë si përfituese e grantit 2023.

Vlera e përfituar e Grantit Komunal është 3,200.00 Euro

Lënda 06-413/01- 11563 dt.02.06.2023

Aplikuesja **"Shkozeta Mati"** nr. personal të ID **1170631751**

Komisioni konstaton se aplikuesja e lartë cekur ka plotësuar kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim dhe është vlerësuar me 90 pikë si përfituese e grantit 2023.

Vlera e përfituar e Grantit Komunal është 3,275.00 Euro

Lënda 06-413/01- 11206 dt.30.05.2023

Aplikuesja **"Vlera Hyla"** nr. personal të ID **1241244349**

Komisioni konstaton se aplikuesja e lartë cekur ka plotësuar kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim dhe është vlerësuar me 85 pikë si përfituese e grantit 2023.

Vlera e përfituar e Grantit Komunal është 3,000.00 Euro

Lënda 06-413/01- 11582 dt.02.06.2023

Aplikuesi **"Aldi Hoxha"** nr. personal të ID **124098819**

Komisioni konstaton se aplikuesi i lartë cekur ka plotësuar kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim dhe është vlerësuar me 80 pikë si përfitues i grantit 2023.

Vlera e përfituar e Grantit Komunal është 3,100.00 Euro

Lënda 06-413/01- 11437 dt.01.06.2023

Aplikuesja **"Lida Sylja"** nr. personal të ID **1003454092**

Komisioni konstaton se aplikuesja e lartë cekur ka plotësuar kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim dhe është vlerësuar me 75 pikë si përfituese e grantit 2023.

Vlera e përfituar e Grantit Komunal është 3,873.00 Euro

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Postal address: UÇK Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 390-320-828

kk.rks-gov.net/gjakove/

Lënda 06-413/01- 11291 dt.31.05.2023

Aplikuesi **"Andi Krasniqi"** nr. personal të ID **1170709493**

Komisioni konstaton se aplikuesi i lartë cekur ka plotësuar kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim dhe është vlerësuar me 75 pikë si përfitues i grantit 2023.

Vlera e përfituar e Grantit Komunal është 3,136.00 €uro

Lënda 06-413/01- 11212 dt.30.05.2023

Aplikuesi **"Ernes Muhaxhiri"** nr. personal të ID **1240230778**

Komisioni konstaton se aplikuesi i lartë cekur ka plotësuar kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim dhe është vlerësuar me 70 pikë si përfitues i grantit 2023.

Vlera e përfituar e Grantit Komunal është 2,640.00 €uro

Lënda 06-413/01- 10858 dt.26.05.2023

Aplikuesja **"Silvane Alija"** nr. personal të ID **1008860676**

Komisioni konstaton se aplikuesja e lartë cekur ka plotësuar kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim dhe është vlerësuar me 65 pikë si përfituese e grantit 2023.

Vlera e përfituar e Grantit Komunal është 3,656.00 €uro

Lënda 06-413/01- 11074 dt.29.05.2023

Aplikuesi **"Rinor Beqaj"** nr. personal të ID **1230540876**

Komisioni konstaton se aplikuesi i lartë cekur ka plotësuar kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim dhe është vlerësuar me 65 pikë si përfitues i grantit 2023.

Vlera e përfituar e Grantit Komunal është 3,192.00 €uro

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Postal address: UÇK Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 390-320-828

kk.rks-gov.net/gjakove/

LISTA PËRFUNDIMTARE E BIZNESEVE START UP TË CILËT JANË PËRFITUES TË GRANTEVE KOMUNALE 2023

Lot I Start Up

	Numri I Lëndës	Emri i aplikuesit	Adresa e Biznesit	Shuma e Kërkuar	Piket
1	06-413/01-11425	Altina Podrimja	Rr: Wesley Clark	3 200 €	90
2	06-413/01-11563	Shkozeta Mati	Gjakovë	3 275 €	90
3	06-413/01-11206	Vlera Hyla	Gjakovë	3 000 €	85
4	06-413/01-11582	Aldi Hoxha	Gjakovë	3 100 €	80
5	06-413/01-11437	Lida Syla	Fsh: Lugbunar	3 873 €	75
6	06-413/01-11291	Andi Krasniqi	Gjakovë	3 136 €	75
7	06-413/01-11212	Ernes Muhaxhiri	Gjakovë	2 640 €	70
8	06-413/01-10858	Silvane Alija	Rr: Nikaj	3 656 €	65
9	06-413/01-11074	Rinor Beqaj	Fsh: Rracaj	3 192 €	65
				29 072,22 €	

Komisioni Vlerësues:

Lon Ibishi, Kryesues

Muharrem Sylmetaj, Anëtar

Marigona Mati, Anëtar

Behar Vula, Anëtare

Avnora Morina, Anëtar

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Postal address: UÇK Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 390-320-828

kk.rks-gov.net/gjakove/



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATË:	20.06.2023
REFERENC-Ë:	06/Zyrtarisht
PËR/ZA/TO:	Z. Ferdinand Kolaj, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
CC:	Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	DZHE
NGA/OD/FROM	Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për përfituesit e granteve për vitin 2023
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport për bizneset Start up te diskualifikuara për grantet 2023

RAPORTI

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për Grand 2023.

Lënda 06-413/01-11581 dt.02.06.2023

Aplikuesja "Taulanta Rexha" nr personal 1172657156

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për grantet 2023.

Konstaton se aplikuesja "Taulanta Rexha" nuk kualifikohet pasi që pas verifikimit në ARBK e lartecikuara posedon biznesin e hapur dhe nga data 15/10/2014 dhe të pasivizuar me dt 09.06.2022 me emër Taulanta Rexha B.I. emri tregëtar N.SH. " REAT " Komisioni konstaton se aplikuesja nuk është biznes fillestar apo Start up.

Aplikuesi "Visar Kadriqeli" nr personal 1009237310

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për grantet 2023.

Konstaton se aplikuesi "Visar Kadriqeli " nuk kualifikohet pasi që aplikacioni nuk është përplur plotësisht burimi financiar si dhe mungojnë nënshkrimi dhe data.

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Postal address: UÇK Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 390-320-828

kk.rks-gov.net/gjakove/

Lënda 06-413/01-11267 dt.31.05.2023

Aplikuesi "Erblin Pozhegu" nr personal 1241915502

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për grantet 2023.

Konstaton se aplikuesi "Erblin Pozhegu" nuk kualifikohet si fituese pasi nuk e arrin numrin e pikeve fituese.

Lënda 06-413/01-11604 dt.01.06.2023

Aplikuesi "Valon Këpuska" nr personal 2009821107

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për grantet 2023.

Konstaton se aplikuesi "Valon Këpuska" nuk kualifikohet pasi bije ndesh me kriterin jokualifikues nr.10 ku thuhet : Nëse vlera e financimit të projektit është nën ose mbi shumën e vlerës që financohet nga Komuna" aplikuesi ka kërkuar 4330€ mbi vlerën e financimit 4000€ sipas thirrjes per grante.

Lënda 06-413/01-11557 dt. 02.06.2023

Aplikuesi "Gazmend Berisha" nr personal 1233577746

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për grantet 2023.

